



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim**

Legjislatura e III-të
Nr. 08/08
Prishtinë, më 13.06.2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Sadik Idriz, Kosara Nikolić, Numan Balić, Hafize Hajdini, Hetem Arifi, Zylfi Merxha, Enis Kervan, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha.

Anëtarët jo të pranishëm: Mursejl Haljilji.

Gjithashtu të pranishëm ishin: monitruues nga Zyra e Presidentit, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Arta Hajra, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Informatat përfundimtare lidhur me organizimin e tryezës së rumbullakët me temën:
*“Roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e projekteve për kthim të komuniteteve”***

Kryetari hapi mbledhjen dhe përshëndeti të pranishmit. Njoftoi anëtarët se përgatitjet për takimin e 20 qershorit janë afër finalizimit, kemi disa propozime dhe sugjerime të cilat janë bërë në bashkëpunim me përfaqësuesen e OSCE-së, znj. Jennifer, për të cilën shprehu falënderime për ndihmën e dhënë dhe kërkoi nga anëtarët të japin mendimet dhe propozimet eventuale që mund të kenë.

Jennifer Ober njoftoi anëtarët se është bërë një ndryshim i vendit të mbajtjes së takimit. Hoteli Viktory,

i paraparë për mbajtjen e takimit është i zënë, ndërsa po bëhet përpjekje që takimi të mbahet në objektet e restaurantin “Vila Gërmia”. Përndryshe ofrojë mundësin që të bëjnë ndonjë pyetje, sugjerim apo propozim nga anëtarët lidhur me draft agjendën dhe ftesat.

Sadik idriz kërkoi që për anëtarët e komisionit, të organizohet transporti për në hotel.

Jennifer Ober lidhur me transportin nuk do të jetë problem. Sa i përket agjendës, panelistët kryesorë është paraparë që të flasin nga 5 min, por propozojë që kjo kohë të zgjatet prej 10-15 min. Sa i përket diskutimit, së pari do të flasin anëtarët e komisionit pastaj të tjerët. Njoftoi anëtarët se është në kontakt të vazhdueshëm me kryetarin dhe për çdo gjë mund t’iu drejtohen atij.

Kryetari u pajtua me propozimet e znj. Jennifer që prioritet në diskutim të i’u jepet anëtarëve të komisionit pastaj tjerëve. Vazhdoi se anëtarët do të jenë të lirë të flasin duke respektuar minutazhen e paraparë.

Numan Balić propozoi që një anëtar i Kryesisë së Kuvendit të fletë në fjalën hyrëse dhe zv. Kryeministri, ndërsa nëse vjen këshilltari tij mos të flet. Gjithashtu theksoi se Ministrat e ftuar kanë rol pune dhe duhet të flasin dhe t’iu përgjigjen tona.

Sanije Aliaj kërkoi që ftesë t’iu bëhen të dy zv. Kryeministrave dhe mundësisht njëri të merr pjesë. Gjithashtu propozoi që ftesë t’iu bëhet edhe Ministrit të Pushtetit Lokal sepse kjo Ministri ka rol të rëndësishëm në çështjet e kthimit pasi administron pushtetin lokal në vend.

Xhevdet Neziraj theksoi do të duhej të merrte pjesë zv. Kryeministri, ndërsa këshilltarët e tij duhet participojnë gjithsesi dhe të transmetojnë mesazhin e Qeverisë. Gjithashtu të qendrojnë gjithë kohën edhe këshilltarët e Ministrave që do të ftohen. Rekomandimet që do të nxjerrën të kenë efektin e tyre.

Sanije Aliaj në pikën transparenca financiare, kërkoi që të ftohet dikush nga MEF apo nga Ministrinë e ftuara. Propozoi që përfaqësuesit e Ministrisë së Pushtetit Lokal të cilët janë më kompetent në këtë fushë, të informoj lidhur me ndarjen e mjeteve dhe shpenzimin e tyre për çështjen e kthimit. Ky është një obligim i tyre pasi që, një pjesë e mjeteve për kthim ndahen nga Qeveria, ndërsa pjesa pjesë tjetër nga UNDP-ja.

Numan Balić propozoi që në pjesën transparenca financiare, në vend të z. Koci, të ftohen Ministrinë dhe përfaqësuesit e tyre të buxhetit, që të japin informacione për këto çështje.

Xhevdet Neziraj propozoi që mos të ftohen përfaqësuesit e Departamenti i Buxhetit , sepse ata mund të na informojnë vetëm për shumën e ndarë për këto qëllime, por të ftohen Drejtorët e Departamenteve të Ministrive përkatëse (Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim), të cilat janë kompetent së bashku me UNDP, për menaxhimin e mjeteve për çështjen e kthimit.

Kryetari theksoi se pajtohet me propozimin e znj. Aliaj që të ftohet Ministri i Pushtetit Lokal i cili mund të flas në pjesën e dytë të diskutimit, gjithashtu u pajtua me propozimet, që Drejtorët e Departamenteve të Buxhetit të Ministrive përkatëse të vijën për të raportuar rreth mjeteve që janë të paraparë për çështjet e kthimit. Propozoi që të ftohet edhe përfaqësuesi i USAID, z. Peter Dafin, në cilësinë e mysafirit. Kryetari tha se agjenda do finalizohet së shpejti dhe do ta kenë të gjithë anëtarët.

Mbledhja përfundoi në ora 13:35

Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit

Bojan STOJANOVIĆ

